



KONFERENCË

Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës - sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe Rajon ASHSH & ASHAK

(Datat e zhvillimit të konferencës: 17-18 tetor (parashikim), 2025; Vendi: Tiranë)

Objektivi kryesor i Konferencës së përbashkët ndërmjet ASHSH dhe ASHAK është studimi dhe analiza shkencore e problematikës së ndryshimeve demografike dhe dinamikat e tregut të punës, të para në një këndvështrim më të gjerë, si pjesë e sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri, Kosovë e rajon.

Konferenca do të shërbejë si një platformë për të ndarë idetë, paraqitur studimet e analizat konkrete në funksion të perspektivave të zhvillimeve të problematikës së ndryshimeve demografike dhe dinamikat e tregut të punës, të cilat janë elementë shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik e social në Shqipëri e Kosovë. Synimi kryesor është paraqitja e propozimeve e sugjerimeve konkrete e aktuale nga ana e një komunitetit akademik e shkencor, vendimmarrësve politikë, shoqërisë civile e institucioneve ndërkombëtare, komunitetit të biznesit, etj.

Konferenca do organizohet e zhvillohet si Konferencë shkencore ndërkombëtare duke patur në përbërje të saj edhe profesorë e studiues të shquar ndërkombëtarë të këtyre fushave, si dhe do kërkojë që të ndërtojë edhe partneritete institucionale në organizimin e saj me aktorë të tjerë kombëtarë e ndërkombëtarë, struktura akademike e shkencore, Qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës, etj.

Materialet e plota të konferencës do të botohen në dy publikime të vecanta: në versionin e përmblendhjes së abstrakteve (që do të jenë gati gjatë zhvillimit të konferencës) dhe një botim të vecantë me gjithë prezantimet e pjesëmarrësve (në format artikujsh shkencorë) që do të botohet gjatë 3 muajve të parë të vitit 2026.

Konferenca do të zhvillohet me një sesion plenar (që do paraprihet nga fjalët përshëndetëse) me 6-8 prezantime; dhe dy sesione tematike me nga 8-10 prezantime secili. Njëkohësisht do të

pranohen dhe punime të tjera që do prezantohen si Poster (por që do të jenë pjesë e botimit të punimeve).

Konferenca synon stimulimin e debatit mbi zhvillimet aktuale, idetë e reja, qasjet dhe teoritë më të rëndësishme, masat, politikat dhe strategjitë, shqetësimet dhe sfidat e përbashketa në fushën e ndryshimeve demografike dhe dinamikave (sfidat, arritjet dhe pengesat) të tregut të punës si pjesë e sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri, Kosovë e rajon:

- Rritja ekonomike dhe punësimi – faktorë të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm.
- “Përkthimi” i rritjes ekonomike në mireqenie – sfidat dhe politikat.
- Sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri e Kosovë.
- Informaliteti dhe mirëqënia – faktorët që ndikojnë dhe sfidat për të ardhmen.
- Ndikimi i zhvillimeve demografike në tregun e punës, politikat e pagave dhe pensionet.
- Ndikimet e emigracionit në ndryshimet demografike në Shqipëri e Kosovë.
- Ndikimi i emigrimit dhe migrimit në sipërmarrjen private dhe tregun e punës.
- Organizimi i tregut të punës dhe formimit profesional në Shqipëri e Kosovë.
- Produktiviteti i faktorëve të prodhimit (puna dhe kapitali), rritja ekonomike dhe zhvillimi i qëndrueshëm.
- Dixhitalizimi dhe Teknologjite e reja si një përgjigje ndaj presioneve demografike mbi tregun e punës.
- Pritjet demografike të popullsisë dhe implikimet për modelin e zhvillimit dhe financat publike.
- Kapitali Njerëzor dhe Tregu i Punës - Harmonizimi i kualifikimeve dhe certifikimeve profesionale; Lëvizshmëria e fuqisë punëtore mes dy vendeve; Strategjitë për të ndaluar emigracionin e trurit.
- Kapitali human dhe teknologjia: roli i institucioneve të arsimit të lartë dhe kerkimit shkencor.
- Ekonomia Digjitale dhe Inovacioni - Start-up-et dhe ekosistemi i inovacionit në Shqipëri dhe Kosovë; Inteligjenca artificiale dhe roli i saj në zhvillimin ekonomik.
- Integrimi European dhe konkurrueshmëria e ekonomisë - shtysa për përshpejtimin e rritjes ekonomike.
- Politikat e reja industriale në kontekstin e rivaliteteve të sotme gjeostrategjike e gjeoekonomike.

Afatet:

1. Shpallja e thirrjes për pjesëmarrje në konferencë: 5 maj 2025
2. Shprehje e interesit/ tema e propozuar (plus një abstrakt i shkurtër i temës dhe një bio e autorit/autorëve): deri në dt. 15 qershor 2025
3. Njoftimi i pranimit të temës nga komisioni organizativ: 5 korrik 2025
4. Dorëzimi i punimeve nga autori/autorët në version të plotë: 30 shtator 2025
5. Zhvillimi i konferencës: 17-18 tetor 2025
6. Botimi i plotë i materialeve të konferencës: prill 2026
7. TIRANË

BORDI I NDERIT ASHSH dhe ASHAK

1. Akademik Skënder Gjinushi
2. Akademik Mehmet Kraja
3. Akademik Hivzi Islami
4. Akademik Fejzullah Krasniqi
- 2- Ministri i Arsimit dhe i Sportit
3. Kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Kuvendi i Shqipërisë
4. Përfaqësuesi i Komisionit të Edukimit në Kuvendin e Shqipërisë
5. Genti Sejk, Guvernatori i BSH
6. Përfaqësues i Bankës Botërore

Bordi shkencor: ASHSH

1. Akademik Anastas Angjeli
2. Akademik Vasil S. Tole
3. Akademik. Prof. Anila Hodo
4. Akademik Adrian Civici
5. Akademik Kosta Barjaba
6. Prof.assoc.Dr. Nikollaq Pano
7. Prof.assoc.Dr.Selami Xhepa

BORDI SHKENCOR: ASHAK

1. Akademik Fejzullah Krasniqi
2. Prof. Dr. Muhamet Mustafa
3. Akademik Abdylmenaf Behxheti
4. Anëtar korrespondent Gjyljeta Mushkolaj
5. Prof. Dr. Nail Reshidi
6. Prof. Dr. Veland Ramadani

8. Prof. Dr. Klodiana Gorica
9. Prof. Dr. Kozeta Sevrani
10. Prof asoc. Dr. Benard Dosti
11. Prof. Dr. Artan Hoxha
12. Nikolin Jaka, Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
13. Luan Bregasi, Kryetari i Dhomës Kombëtare të Zëjtarisë
14. Ines Mucostepa, Kryetare e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë

7. Prof. Dr. Gazmend Qorraj
8. Prof. Dr. Linda Grapci-Kotori
9. Prof. Dr. Valentin Toçi
10. Dr. Alban Hashani
11. Prof. Dr. Adhurim Haxhimusa
12. Prof. Dr. Halil Ibrahim
13. Prof. Dr. Musa Rizaj
14. Dr. Azem Rexha

Komiteti organizator:

ASHSH

- Akademik Anastas Angjeli - Kryetar
- Akademik Adrian Civici;
- Akademik Kosta Barjaba;
- Prof.assoc.Dr.Selami Xhepa;

ASHAK

- Akademik Isa Mustafa;
- Akademik Justina Shiroka Pula;
- Akademik Besnik Krasniqi;

Sekretaria e konferencës:

1. Vitore Veli;
2. Albana Bogdani
3. Drisela Diamanti
4. Klea Lleshi

Komunikimi dhe kontakti

Të gjitha komunikimet do të bëhen me anë të email në Sekretariatit e Konferencës

ASHAK

Kontaktoni: Besnik KRASNIQI

E-mail: besnikkrasniqi@ashak.org

Web: www.ashak.org

Tel: +38345300554

Prishtinë

ASHSH

Sekretaria: Vitore VELI

E-mail: vitoreveli@gmail.com

Web: www.akad.gov.al

Tel, Cel: 00355682339639

Tiranë

Për dorëzimin e temës, abstraktit apo punimit të plotë, për studiuesit nga Shqipëria do të kontaktoni në adresën e email: Albana.Bogdani@akad.gov.al dhe klealleshi@umsh.edu.al, ndërsa për studiuesit në Kosovë, në adresën e email-it: besnikkrasniqi@ashak.gov